



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:098827

Datë: 24.09.2021

Numri i dokumentit: 02207824

**P.nr.566/21**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL** Sipas gjyqtarit Refki Piraj, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Halime Nixha në lëndën penale kundër të pandehurit personit përgjegjës ne personin juridik Sh.D., dhe personi juridik .....– SHPK te cilën e përfaqëson Z.D., , për shkak te veprës penale shmangja nga tatimi nga neni 313 par.2 lidhur me par.1 te të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082 (KPRK), duke vendosur sipas aktakuzës PP/II.nr.352-14/20 , të datës 24.05.2021 në praninë e Prokurorit të Shtetit Labinot Jetishi, të pandehurve personit përgjegjës ne personin juridik Sh.D., dhe personi juridik ..... – SHPK te cilën e përfaqëson Z.D., me mbrojtësin av. V.O., me datë 23.09.2021 mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri personit përgjegjës ne personin juridik Sh.D., i lidhur me .....ne Prizren, me banim ne rr. ....nr. ...., nga i ati ....., e ema .....e lind. ...., ka te kryer fakultetin ekonomik, i martuar babe i 3 fëmijë, i gjendjes se mesme ekonomike , turk shtetas i R. te Kosoves.

E pandehura, personi juridik .....- Sh.P.K të cilën e përfaqëson Z.D.,.

**JANE FAJTOR**

Personi përgjegjës i personit juridik – Sh.D.,

Ne periudhën kohore prej janar 2016 deri ne muajin Shkurt 2019, me qellim qe te fsheh apo ti shmanget pjesërisht apo tërësisht pagesës se tatimit apo kontributeve te tjera qe kërkohen me ligj, jep te dhëna te pavërteta dhe nuk i përfshinë te dhënat lidhur me te ardhurat e tij, pasurinë, gjendjen ekonomike apo faktet e tjera relevante per vlerësimin e detyrimeve te tilla i pandehuri si person përgjegjës i personit juridik .....SH .P K. duke vepruar ne kuadër te veprimtarisë se tij afariste nuk deklaroi te hyrat e realizuara ne kuadër te aktivitetit afarist te biznesit përkatësisht mbi deklaroi T.V.SH. per periudhën tatimore 01.2016 , 02.2016, dhe 04.2016, ne vlere prej 5,933.90 euro, i shmangte tatimit ne te ardhurat personale, kontributet pensionale dhe tatimit ne qira per periudhat tatimore prej 01.2017 deri me 02.2019, ne vlere prej 10.975.47 euro dhe i shmangte deklarimit per pagesën e tatimit e te ardhurat e korporatave per periudhën e vitit 2016 dhe 2018 ne vlere prej 3.520.30 euro, veprime këto me te cilat administratës tatimore te Kosoves respektivisht buxhetit te R. te Kosoves i shkakton dem substancial ne vlere prej 20.429.67 euro.

**Këso dore ka kryer veprën penale shmangja nga tatimi nga neni 313 par.2 lidhur me par.1 te Kodit Penal të Republikës së Kosovës.**

I pandehuri personi juridikë .....– Sh.P.K

Ne periudhën kohore prej janar 2016 deri ne muajin shkurt 2019, me qellim qe te fsheh apo ti shmanget pjesërisht apo tërësisht pagesës se tatimit apo kontributeve te tjera qe kërkohen me ligj, jep te dhëna te pa vërteta dhe nuk i përfshinë te dhënat lidhur me te ardhurat e tij , pasurinë, gjendjen ekonomike apo fakte te tjera relevante për vlerësimin e detyrimeve te tilla , i pandehuri kompania e sigurimeve ..... SH.P.K. duke vepruar ne kuadër te veprimtarisë se tij afariste nuk deklaroi te hyrat e realizuara ne kuadër te aktivitetit afarist te biznesit përkatësisht mbi deklaroi TVSH. Për periudhën tatimore 01.2016, 02.2016, dhe 04. 2016 ne vlere prej 5.933.90 euro, i shmanget tatimit , ne te ardhurat personale kontributet pensionale dhe tatimit ne qira per periudhat tatimore prej 01.2017 deri me 02.2019, ne vlere prej 10.975.47 euro dhe i shmanget deklarimit per pagesën e tatimit e te ardhurat e korporatave për periudhën e vitit 2016 dhe 2018 ne vlere prej 3.520.30 euro, veprime këto me te cilat administratës tatimorë te Kosoves respektivisht buxhetit te R. te Kosoves i shkaktonte dem substancial ne vlere prej 20.429.67 euro

**Këso dore ka kryer veprën penale shmangja nga tatimi nga neni 313 par.2 lidhur me par.1 te Kodit Penal të Republikës së Kosovës.**

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 41, 42, 43, 46, 73, dhe nenit 233 te KPP te akuzuarve ua shqipton :

**DËNIM ME GJOBE**

Te akuzuarit – personit përgjegjës ne personin juridik .....– SHPK Sh.D., per veprën penale nen I te dispozitivit te aktakuzës ne shume prej 1.300 (njëmijetreqind) euro, dhe

Denim me burg ne kohëzgjatje prej 6 muajve ashtu qe konforme nenit 47 te KP dhe me pajtimin e te pandehurit dënimi me burgim do ti zëvendësohet me denim me gjobe ne shume prej 1.200 (njëmijedyqind) euro, qe do te thote dënim kumulativ me gjobe ne shume prej 2.500 (dymijepesëqind) euro. . te cilin dënim do ta paguajnë ne xhirollogarinë e kësaj gjykata nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Te akuzuarës personit juridik .....– SH FK te cilën e përfaqëson Z.D., per veprën penale nen II. te dispozitivit te aktakuzës ne shume prej 3.000 (tremijë) euro te cilin dënim do ta paguajnë ne xhirollogarinë e kësaj gjykata nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi, e poqe se dënimi me te holla nuk mund te paguhet nga ana e te akuzuarve ne afatin ligjore i njëjti do te zëvendësohet me dënim me burg duke llogaritur 20 euro për 1 dite burg

E dëmtuara ATK per realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest te rregullt civil.

Obligohen t i pandehurve qe ti paguaj te gjitha shpenzimet e procedurës penale sa ato bëhen ne baze te llogarisë se gjykatës, kurse ne emër te paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 20 euro, e te gjitha këto ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nen kërcenim te ekzekutimit te dhunshëm.

Gjykata lejon qe dënimi me gjobe te paguhet me këste dhe ate te akuzuarit Sh.D., qe te paguaj per qdo fillim te muajit nga dt.01.deris me dt. 05, shumen prej nga 250

(dyqindpesëdhjetë) euro ne 10 keste, kurse te akuzuarës personi juridik SFK SHPK., per qdo fillim te muajit nga dt.01.deri me dt. 05, shumen prej nga 250 (dyqindpesëdhjetë) euro ne 12 keste . Mundësia e pagesës me këste do te revokohet nëse te dënuarit nuk e paguajnë këstin me kohe.

Ne zbatim te ligjit mbi mbrojtjen e viktimave te krimit te akuzuarve iu caktohet secilit taksa ne lartësi prej nga 30 euro te cilën është i obliguar ta paguaj ne xhirollogarinë e kësaj gjykate ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.352-14/20 , të datës 24.05.2021 , kundër të pandehurit personit përgjegjës ne personin juridik Sh.D., dhe personi juridik .....– SHPK te cilën e përfaqëson Z.D., , për shkak te veprës penale shmangja nga tatimi nga neni 313 par.2 lidhur me par.1 te të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082 (KPRK),

Prokuroria Themelore ne Prizren – Departamenti i përgjithshëm përkitazi lidhur me aktakuzën PP/II.352-14/20 e dt. 21.05.2021 , me te akuzuarin personit përgjegjës ne personin juridik Sh.D., dhe personi juridik .....– SHPK te cilën e përfaqëson Z.D., i dhe mbrojtësin av. V.O., kane hyre ne marrëveshje për pranimin e fajësisë.

Në shqyrtimin e dt.23.09.2021 i mbajtur ne këtë çështje penale përkitazi për marrëveshjen e cekur me lartë gjykata bazuar ne nenin 233 te KPP-së, ka vlerësuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë i ka dëgjuar te akuzuarit ne prezencën e mbrojtësit , dhe ka konstatuar se pranimi është bere vullnetarisht nga ana e te akuzuarve pas konsultimeve te mjaftueshme me mbrojtësin e tij.

Gjyqtari gjykues konstaton se janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara ligjore konform nenit 233 paragrafi 18 i KPP-së, andaj ka pranuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe pas përfundimit të dëgjimit në seancë ka shqiptuar edhe dënimin në suazat e marrëveshjes në mes të palëve.

Vendimi mbi lejimin qe dënimi me gjobe te paguhet me këste u muar nek upitm te nenit 46 pr.2 te KPPKse.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë ne kuptim te nenit 450 dhe 452 të te KPPK-se.

Vendimi mbi udhëzimin në kontest te rregullt civil u mbështet ne neni 463/2 te KPPK

Më sa u tha më lartë u vendos si ne shqiptim të këtij aktgjykimi .

## **GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2021:098827, 24.09.2021**

**G j y q t a r i**

Refki Piraj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.